



Kujdesem për veten, familjen time, mbrohem me PrEP





1.

**ÇFARË ËSHTË
PrEP?**



NJË TRAJTIM KUNDËR HIV

PrEP më mbron kundër HIV, por jo nga infeksionet seksualisht të transmetueshme.

PrEP mbron personat që nuk janë infektuar me HIV.

PrEP nuk pengon mbetjen shtatzënë.





2.

**PËR KË ËSHTË
PrEP ?**



|| PËR TË GJITHË

Të gjithë mund të përfitojnë prej PrEP sipas situatës së gjithsecilit dhe pas diskutimit me mjekun.

Nuk kam a.M.E ose sigurim për sëmundje



✓ Është OK

Nuk Kam Dokumente



✓ Është OK

Nuk kam para



✓ Është OK



3.

**SI MERRET
PrEP ?**

MUND T'I KËRKOJ RECETËN PËR PREP




MJEKUT TIM



NË SPITAL



NË NJË QENDËR
DEPISTIMI
OSE QENDËR
SHËNDETËSORE




KONSULTIMI IM I PARË



POR SI
FUNKSIONON
KJO ?

Mjeku më shpjegoi se çfarë është **PrEP**, **ekzaminimet për t'u kryer** dhe nëse ky mjekim është **i përshtatshëm për, mua.**





Mund **të tërheq mjekimin** në
farmaci.

E MARRIM ATË ÇDO DITË



Është e lehtë,
unë e marr atë
çdo ditë në një
orë të caktuar
dhe gjatë vaktit,
nëse kjo është e
mundur.

NJË TAKIM ÇDO 3 MUAJ



1 takim me mjekun tim **çdo 3 muaj** për të bërë **një kontroll shëndetësor** dhe **rinovuar PrEP-in** tim.



4.

**PSE DUHET
MARRË PrEP ?**



PrEP
parandalon
infektimin tim
me HIV, ajo më
mbron

Me **PrEP,**
mbrohem,
kujdesem
për veten dhe
partnerët e
mi

PrEP është
efikase nëse
merret siç
duhet

PrEP më
lejon **të jem**
autonom/-e
në raport me
mbrojtjen time
HIV





5.

**PARANDALIMI
I KOMBINUAR**



PrEP mbron vetëm kundër HIV dhe jo kundër sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme.


Mendoj gjithashtu :



Për **prezervativin** që më **mbron prej të gjitha infeksioneve të tjera seksualisht të transmetueshme** (HIV, Sifiliz, Hepatitet, Klamidia, Gonokoku...)



Të kërkoj një **depistim të rregullt**. Është **falas** dhe **anonim** në qendrat e depistimit (CeGIDD)



Për **Trajtimin e Urgjencës** kundër **HIV** : TPE është një **ilaç** tjetër që lejon **mbrojtjen kundër HIV**. Ai merret **pas një risku** (problem me prezervativin për shembull). Ai duhet të merret më **së voni 48 orë pas raportit seksual të pambrojtur**.

Më shumë informacion në faqen
masantesexuelle.fr

